



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

**RAPORT I**

**Data**  
31.12.2020

**GRUPIT TË PUNËS PËR “VLERËSIMIN E MUNDËSISË PËR VOTIMIN NGA  
JASHTË VENDIT”**

**Nr.**  
**Protokolli**

**PJESA E PARË – REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, pika 2, nenet 24 e 25 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, me urdhrin nr. 91, datë 31.10.2020, ngriti grup pune për vlerësimin e mundësisë për votimin nga jashtë vendit në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021, të shtetasve që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Grupi i punës u angazhua për realizimin e detyrave të përcaktuara nga Komisioneri:

1. Të vlerësojë mundësinë e votimit nga jashtë vendit, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021 të shtetasve me të drejtë vote, të cilët e kanë rezidencën jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Të përgatisë një vlerësim mbi llojin, procedurën e votimit, manuale ose elektronike, duke marrë në konsideratë kushtet e vendit tonë.
3. Të përgatisë një vlerësim mbi procesin e votimit dhe administrimin e votave dhe përfshirjen e tyre në rezultatin e zgjedhjeve.
4. Të bëjë një vlerësim të përgjithshëm mbi kostot financiare.
5. Të përgatisë një listë me akte juridike dhe protokolle teknike që do të bëjnë të mundur votim nga jashtë vendit.
6. Të prezantojë modele të këtij lloji votimi në vende të ndryshme.

**Hyrje**

Ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor, nenet 24 e 25, përcaktuan kompetencat e KQZ-së për të udhëhequr dhe mbikëqyrur procesin për përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave që mundësojnë votimin nga jashtë vendit në zgjedhjet për Kuvendin, për zgjedhësit që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Për realizimin e detyrave grupi i punës u konsultua me përfaqësues të grupeve të ndryshme të diasporës jashtë vendit nëpërmjet diskutimeve on-line, është konsultuar me institucione publike

dhe organizata ndërkombëtare<sup>1</sup>. Procesi i konsultimit gjithëpërfshirës ndihmoi Grupin e Punës për të kryer një analizë të plotë të mundësive të votimit të shtetasve shqiptarë me vendbanim jashtë territorit të vendit, qasjes së praktikave të rasteve studimore të referuara me realitetin e vendit tonë. Në përfundim, grupi i punës i paraqet Komisionerit këtë raport.

Kodi Zgjedhor, në nenin 25, përcakton procedura të përgjithshme për votimin nga jashtë vendit, ku përfshihen kryesisht afate për çeljen dhe mbylljen e votimit, garancitë ligjore për vëzhgimin, monitorimin dhe aksesin në KQZ gjatë administrimit të votave, për testimin, verifikimin dhe sigurinë e materialit zgjedhor apo të sistemeve të teknologjisë së informacionit, të cilat nuk mund të jenë më të ulëta sesa ato për votimin brenda vendit.

Neni 46, pika 3, e Kodit Zgjedhor përcakton se “Lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit përfshin vetëm zgjedhësit me vendbanim jashtë vendit, të cilët deklarojnë vullnetin për të ushtruar të drejtën e votimit, sipas rregullave të dala në zbatim të nenit 24 të këtij ligji.”

Kushtet që duhet të plotësojnë shtetasit shqiptarë për të votuar nga jashtë vendit përcaktohen në nenin 24 të Kodit Zgjedhor:

1. Të kenë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile adresën e vendbanimit të përhershëm jashtë vendit, dhe
2. Të kërkojnë nga KQZ-ja që të pajisen me dokumentacionin e votimit nga jashtë.

Procedurat për regjistrimin në RKGJC të adresës së shtetasit me vendbanim të përhershëm jashtë vendit, janë të përcaktuara me ligjin 14/2016 “Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të zbatim të këtij ligji.

Ligji 14/2016 dhe VKM Nr. 915 datë 04.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për njoftimin e detyrimit për vetë deklarin e adresës nga shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të RSH, të procedurës së plotësimit e të dorëzimit të formularit të vetë deklarimit, dhe të dokumenteve shoqëruese të tij, administrimin e tyre nga autoritetet përgjegjëse si dhe të shërbimeve të tjera që ofrojnë këto autoritete ndaj shtetasve”, përcaktojnë se identifikimi i adresës së shtetasve shqiptarë, të cilët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, bëhet nëpërmjet vetë deklarimit “on-line” dhe nga autoritetet përgjegjëse, që janë DPGJC dhe nëpunësit e autorizuar në misionet diplomatike/konsullore.

Shtetasi plotëson formularin tip të vetë deklarimit të publikuar në faqen zyrtare të e-Albania ose pranë zyrave përkatëse që kryejnë këtë shërbim.

Pika 9 e VKM Nr. 915 datë 04.11.2020 përcakton qartë se autoritetet përgjegjëse i ofrojnë shtetasit shqiptar, në adresën e vetë deklaruar e të konfirmuar prej tyre edhe shërbimin e ushtrimit të së

<sup>1</sup> Prezenca e OSBE në Shqipëri ofroi mbështetje me ekspertizë teknike për KQZ. Eksperti për çështjet zgjedhore dhe demokracinë Z. Armin Rabitsch, ndihmoi punën e grupit përmes një studimi krahasues mbi votimin e shtetasve nga jashtë vendit, hartuar bazuar në praktika të votimit me postë nga jashtë vendit, me qasje standardet ndërkombëtare dhe praktikat e mira, përfshirë krahasimin e rasteve studimore të pesë shteteve Austria, Bosnja Hercegovina, Kroacia, Maqedonia e Veriut, dhe Sllovenia.

drejtës së votës, në zbatim të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

## KRIJIMI I LISTËS SË ZGJEDHËSVE QË VOTOJNË JASHTË VENDIT

### 1. Mënyra e parë

#### 1.1. Procedura

**1.2.** Lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit përfshin vetëm zgjedhësit me vendbanim jashtë vendit, që kanë regjistruar adresën në RKGJC dhe deklarojnë vullnetin për të ushtruar të drejtën e votimit, sipas rregullave të parashikuara në zbatim të nenit 24 të Kodit Zgjedhor.

**1.3.** KQZ për zgjedhësit me vendbanim jashtë vendit do të mundësojë shërbimin on-line për të paraqitur kërkesën për t'u përfshirë në listën e zgjedhësve që votojnë jashtë vendit.

**1.4.** Për shkak të pamundësisë kohore, dhe kapaciteteve teknike të kufizuara, vlerësohet që ky shërbim për këto zgjedhje të ofrohet nëpërmjet infrastrukturës e-albania.

**1.5.** Portali e-albania administrohet nga AKSHI, që është i vetmi institucion publik i cili mundëson komunikim të sigurt dhe ndërveprim ndërmjet institucioneve qeveritare.

**1.6.** Shërbimi i KQZ-së do të ndër-veprojë me bazën e të dhënave të RKGJC-së, për të shfrytëzuar përbërësit zgjedhorë të shtetasve dhe për të mundësuar evidentimin e shtetasve që kanë regjistruar adresën e vendbanimit të përhershëm jashtë territorit të vendit dhe të atyre shtetasve që nuk e kanë kryer këtë regjistrim.

**1.7.** Zgjedhësve me vendbanim jashtë vendit, do t'u kërkohen të dhënat personale si emër, mbiemër, atësi, datëlindje, numër personal identifikimi, adresa e vendbanimit të përhershëm, adresa elektronike e-mail si dhe numri telefonik i celularit.

Zgjedhësi me vendbanim jashtë vendit, pasi ka plotësuar të dhënat sipas pikës 1.1.5, dërgon kërkesën për të votuar nga jashtë vendit nëpërmjet shërbimit on-line të KQZ-së.

**1.7.** Shërbimi on-line i KQZ-së i mundëson zgjedhësit të aksesojë në mënyrë të menjëhershme plotësimin e të dhënave të përcaktuara në pikën 1.1.5.

**1.8.** Numri personal i identifikimit si dhe të dhënat e tjera të zgjedhësit do të krahasohen nëpërmjet shërbimit të KQZ-së me bazën e të dhënave të RKGJC-së. Nga rezultati i këtij krahasimi do të vërtetohet nëse zgjedhësi ka regjistruar adresën e vendbanimit të përhershëm jashtë vendit, si dhe do të vërtetohet saktësia e përbërësve zgjedhor të tij.

**1.9.** Verifikimi nga DPGJC-ja i të dhënave të kërkesës së zgjedhësve me vendbanim të përhershëm jashtë vendit kryhet jo më vonë se dy ditë nga dërgimi i saj.

**1.10.** Shërbimi i KQZ-së, nëpërmjet adresës e-mail të zgjedhësit, konfirmon ose jo paraqitjen e kërkesës për të votuar nga jashtë vendit.

**1.11.** Nëse zgjedhësi ka mangësi në plotësimin e të dhënave, shërbimi i KQZ-së do të mundësojë njoftimin e zgjedhësit nëpërmjet adresës e-mail për plotësimin e tyre.

**1.12.** Nëse kërkesa e zgjedhësit nuk konfirmohet, zgjedhësi ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë KQZ-së. Ankesa paraqitet brenda 24 orëve nëpërmjet adresës e-mail të përcaktuar nga KQZ-ja për këtë qëllim.

**1.13.** KQZ shqyrton ankesën dhe brenda dy ditëve nga paraqitja e saj i kthen përgjigje shtetasit. Në rast se refuzimi i kërkesës për të votuar nga jashtë vendit ka shkak mos përmbushjen e kriterit ligjor të regjistrimit të vendbanimit jashtë vendit, shtetasi informohet për veprimet që duhet të ndërmarë dhe afatin e kryerjes së tyre. Në rast se refuzimi i kërkesës për të votuar nga jashtë vendit ka shkak pasaktësi të të dhënave, KQZ e referon rastin në DPGJC dhe njofton shtetasin për plotësuar apo saktësuar të dhënat e tij. KQZ, në këto raste komunikon me shtetasin përmes adresës e-mail të përcaktuar nga KQZ për këtë qëllim.

**1.14.** DPGJC, rast pas rasti, përcjell në KQZ, elektronikisht dhe në formë shkresore, të dhënat e shtetasve me vendbanim jashtë vendit të cilët kanë plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 24, paragrafi 1 të Kodit Zgjedhor.

**1.15.** Për këto zgjedhje, afati për paraqitjen e kërkesës nga zgjedhësit me vendbanim të përhershëm jashtë vendit, do të fillojë pasi KQZ të ketë miratuar aktin normativ për procedurat e detajuara të votimit nga jashtë vendit. Afati i përfundimit të paraqitjes së kërkesave, do të jetë data 24 shkurt 2021. Afati i përfundimit referon afatin e parashikuar në nenin 54, paragrafi 1, që përcakton se kërkesat për ndryshime në ekstraktin e përbërësve zgjedhor nuk mund të paraqiten me vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve.

**1.16.** KQZ nëpërmjet auditëve teknikienë, mbikëqyr verifikimin e të dhënave nga DPGJC.

**1.16.1.** Auditët teknikienë kontrollojnë përputhshmërinë e veprimeve të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me rregullat e përcaktuara në nenin 24 të Kodit Zgjedhor dhe aktin normativ të KQZ-së.

**1.16.2.** Auditët teknikienë i paraqesin një raport auditimi çdo javë KQZ-së për gjetjet e auditimit. Secili nga auditët teknikienë mund të paraqesë raport individual nëse ka opinion apo koment të ndryshëm nga auditit tjetër.

**1.16.3.** KQZ-ja ia përcjell gjetjet dhe rekomandimet e auditëve teknikienë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile brenda 48 orëve, duke i kërkuar njëkohësisht shpjegime për to. Raportet e auditëve dhe shpjegimet e DPGJC-së bëhen publike nga KQZ-ja. Detyra e auditëve teknikienë për mbikëqyrjen e hartimit të listës së zgjedhësve nga jashtë vendit përmbushet me raportin përfundimtar pas shpalljes së kësaj liste.

**1.16.4.** Jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve, DPGJC kryen ndryshimin në listën e zgjedhësve, duke i vendosur zgjedhësit që plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 24 të Kodit Zgjedhor në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit.

**1.16.5.** Lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit shpallet në formë elektronike në faqen zyrtare të KQZ-së dhe në portalin e-albania. Format i elektronik i mundëson zgjedhësit verifikimin e të dhënave të tij në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit.

## **1.1. Fushata informuese e KQZ-së**

**1.1.1.** KQZ përmes reklamave televizive të transmetuara në media dhe portale, do të informojë zgjedhësit me banim jashtë vendit për procedurat e regjistrimit, të drejtat dhe detyrimet e tyre në këtë proces, dhe për adresën e-mail të KQZ-së ku shtetasi mund të paraqesë ankesë në rast të mos-konfirmimit të kërkesës për të votuara nga jashtë vendit.

**1.1.2.** Fushata informuese do të fillojë nga momenti i miratimit të aktit normativ për procedurat e detajuara të votimit nga jashtë vendit dhe do të zgjasë deri në përfundimin e afatit të regjistrimit.

## **1.2. Modele të vendeve të tjera**

**1.2.1.** Austria: Lista e përhershme e zgjedhësve mbahet në ZGJC në çdo bashki në bazë të regjistrimit civil. Zgjedhësit që banojnë jashtë vendit caktohen në vendbanimin më të fundit që kanë pasur para largimit. Aplikimi qoftë “on-line” apo manualisht, nga austriakët të cilët banojnë jashtë vendit të tyre duhet të paraqesin kopje të pasaportës/ID-së, leje drejtimi dhe ja dërgon njësisë administrative me postë, fax, e-mail (të skanuar) ose personalisht. Në këtë formulari ai mund të kërkojë të përfshihet në listën e zgjedhësve (evropian, jashtë vendit). Regjistrimi i shtetasve austriakë të cilët kanë vendbanim të përhershëm jashtë vendit kërkohet të kenë aplikim aktiv (me status aktiv) për tu pranuar në listën e zgjedhësve (regjistri i votuesve). Aplikanti identifikohet me një kartë identiteti apo nënshkrim telefonik mobile, kodi aplikimi (i cili i dërgohet votuesit me një informacion zgjedhor zyrtar); me një numër pasaportë ose me një foto ID-je të skanuar. Gjithashtu votuesit austriak mund të dorëzojnë aplikimin e tyre edhe fizikisht ose me e-mail në njësitet administrative ku ata kanë jetuar.

**1.2.2.** Bosnja dhe Hercegovina: KQZ-ja është përgjegjëse për mirëmbajtjen e Listës së zgjedhësve për saktësinë dhe integritetin e saj. Regjistrimi “on-line” nuk lejohet. Zgjedhësit që banojnë jashtë BeH-së duhet të dorëzojnë një kopje të kartës ID me postë. Kartat e huaja pranohen vetëm për refugjatët por jo për zgjedhësit që banojnë përkohësisht jashtë vendit. Ligji nuk kërkon provë për adresën jashtë vendit apo për shkak të problematikave që i krijon KQZ-së përfshirë adresat e rreme, apo regjistrime të shumëfishta në të njëjtën adresë. Zgjedhësit jashtë vendit janë të detyruar të dorëzojnë aplikimin e nënshkruar për tu përfshirë në listën e zgjedhësve jashtë vendit për çdo zgjedhje dhe të konfirmojnë apo ndryshojnë regjistrimet e mëparshme nëpërmjet postës. Në aplikim duhet të zgjedhin nëse do të votojnë fizikisht në misionet

diplomatie apo me postë. KQZ-ja përgatit një listë zgjedhësish të veçantë dhe i përjashton ato nga lista kryesore e zgjedhësve që votojnë në QV të rregullta.

**1.2.3.** Sllovenia: Lista e zgjedhësve nga jashtë ndahen në dy kategori: a) Zgjedhës që kanë të regjistruar vendbanimin e përhershëm jashtë vendit; b) zgjedhës që kanë emigruar nga Sllovenia dhe hyjnë në një listë të posaçme të cilët nuk e kanë të regjistruar vendbanimin e përhershëm jashtë Sllovenisë. Zgjedhësit pa një vendbanim të përhershëm në Slloveni kanë të drejtë të votojnë në njësinë zgjedhore ku ata ose prindërit e tyre kanë pasur vendbanimin e përhershëm. Sllovenia ka një sistem pasiv të regjistrimit të zgjedhësve. Vendbanimi i përhershëm jashtë vendit mund të deklarohet nëpërmjet portalit “e-uprava” (administratë elektronike) duke përdorur nënshkrim elektronik që përkon me nënshkrimin e personit, në përputhje me legjislacionin e transaksioneve dhe nënshkrimeve elektronike. Shtetasit që nuk kanë vendbanimin e përhershëm në Slloveni nëse duan të votojnë me postë duhet të njoftojnë KQZ-në për nëpërmjet një formati të publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së Slloveni, e cila nënshkruhet dhe skanohet dhe përcillet me postë, faks, e-mail. Zgjedhësit kanë edhe opsionin për tu regjistruar me shkresë. Lista e zgjedhësve nuk publikohet dhe nuk shpërndahet me qëllim ruajtjen e të dhënave personale.

## 2. Mënyra e Dytë

### 1.1. Procedura:

**1.1.1.** Në KQZ do të ngrihet një sistem për regjistrimin dhe administrimin e kërkesave nga shtetasit shqiptarë me vendbanim të përhershëm jashtë territorit të RSH-së për të shprehur dëshirën e tyre të votojnë në zgjedhjet për Kuvend. Sistemi do t’ju kërkojë shtetasve shqiptarë me vendbanim të përhershëm jashtë territorit të RSH të dhëna identifikuese të tilla si:

**1.1.1.1.** Pasaportë ose kartën ID shqiptare, të vlefshme;

**1.1.1.2.** Adresën në shtetin ku jeton (ka rezidencën e përhershme);

**1.1.1.3.** Të dhënat e kontaktit të tilla si e-mail dhe numër telefoni celular/mobil;

**1.1.1.4.** Në mënyrë opsionale mund të kërkohen edhe të dhëna që provojnë se ai është në emigracion (dokument identifikimi apo leje qëndrimi në shtetin në emigracion, kontratë shtëpie ose dokument pronësie, kontratë me ujësjellës/energji/gaz, kontratë punësimi, kontratë shkollimi...).

**1.1.1.5.** Sistemi do të kërkojë zgjedhësit/aplikantit nëse ai/ajo ka aplikuar në shërbimin që ofrohet nga DPGJC për të deklaruar vendbanimin e përhershëm jashtë vendit?

**1.1.1.5.1.** Nëse përzgjidhet “Jo”, do të njoftohet me një mesazh paralajmërues për detyrimin që ka shtetasi të aplikojë pranë shërbimit në

DPGJC për të regjistruar vendbanimin e ri dhe se aplikimi i tij nuk do të vazhdoj të përpunohet pa kryer regjistrimin duke i ofruar linkun përkatës.

**1.1.1.5.2.** Nëse përzgjidhet “Po” sistemi e informon se ai është pjesë e listës së zgjedhësve që banojnë jashtë vendit dhe shtetasi nuk do të jetë në listën natyrale të zgjedhësve me vendbanim në RSH.

## **1.2. Siguria dhe procedura që do të ndiqet.**

**1.2.1.** Ky sistem do të komunikojë me bazat e të dhënave shtetërore si regjistri i gjendjes civile, regjistri i adresave të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit apo regjistra të tjerë që mund të ndihmojnë në verifikimin dhe saktësimin e të dhënave të shtetasve nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit. Standardet e bazave shtetërore të të dhënave, protokollet teknike të ndërveprimit dhe komunikimit të të dhënave ofrojnë sigurinë për integritetin e tyre.

**1.2.2.** Sistemi pas konsultimit të të dhënave me bazat e dhëna shtetërore të tjera (RKGJC-së, RKASHJJ-së, etj.)

**1.2.2.1.** Nëse këto të dhëna përputhen, përfshirë edhe adresën e vetë deklaruar jashtë shtetit finalizon regjistrimin në sistem. Sistemi i dërgon me e-mail në kontaktet e deklaruara email/sms linku-n e tij/saj personal/unik dhe të dhënat e tij personale/unike për të marrë pjesë në votim.

**1.2.2.2.** Nëse këto të dhëna nuk përputhen, përfshirë edhe mos regjistrimin e vendbanimit të përhershëm jashtë territorit të RSH, sistemi do të njoftojë automatikisht shtetasin për rezultatet e mospërputhshmërisë /mosregjistrimin.

## **1.3. Periudha e regjistrimeve.**

**1.3.1.** Si rregull aplikimet për t’u përfshirë në regjistrin e zgjedhësve që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë territorit të RSH fillojnë jo më vonë se 5 ditë nga data e shpalljes së dekretit të Presidentit të Republikës për përcaktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvend.

**1.3.2.** Përjashtim nga ky rregull i përgjithshëm janë zgjedhjet e datës 25 prill 2021. Për këto zgjedhje procedura e regjistrimit do të fillojë menjëherë sapo të jetë miratuar akti normativ dhe të jetë prokuruar sistemi nga KQZ.

**1.3.3.** Ky sistem duhet të pranojë kërkesat për regjistrim jo më pak se 30 ditë para datës së përfundimit të afatit të regjistrimit të kërkesave. Për zgjedhjet e datës 25 prill 2021 kjo periudhë regjistrimi nuk duhet të kalojë datën 11 Mars 2021.

**1.3.4.** Procedura e regjistrimit të zgjedhësve për t’u përfshirë në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit do të përfundojë në përputhje me përcaktimet e nenit 54 të Kodit Zgjedhor, 45 ditë para datës së zgjedhjeve, duke i dhënë kohë KQZ-së dhe audituesve të verifikojnë aneksimin e listës së zgjedhësve nga lista natyrale e zgjedhësve me vendbanim në RSH.

## **1.4. Periudha e verifikimeve të aplikimeve.**

**1.4.1.** Komponenti i ekstraktit të zgjedhësve verifikohet menjëherë online nga sistemi duke u konsultuar me database-n e RKGJC-së /RKASHSHJJ-së.



- 1.4.2.** KQZ jo më vonë se 45 ditë nga data e zgjedhjeve finalizon listën e zgjedhësve duke evidentuar aplikimet për regjistrim të pranuar dhe ato të refuzuara. Të gjitha aplikimet që kanë mbetur të pa trajtuara për arsye dokumentimi do të konsiderohen të refuzuara.
- 1.4.2.1.** Zgjedhësit mund të ankimojnë në përputhje me dispozitat e nenit 57 të Kodit Zgjedhor dhe Kodin e Procedurës Civile në gjykatën administrative që ka në juridiksion gjendjen civile të zgjedhësit.
- 1.5.** Afati i heqjes së zgjedhësve të regjistruar në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit nga lista e zgjedhësve natyrale.
- 1.5.1.** 45 ditë para datës së zgjedhjeve, sistemi referuar RKGJC-së prodhon listën përfundimtare të listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit. Çdo rast/aplikim për tu përfshirë në listën e zgjedhësve jashtë vendit, do të trajtohet individualisht në mënyrë dinamike nga sistemi deri në përfundimin e afatit të mësipërm.
- 1.5.2.** Jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve DPGJC-ja heq nga lista “natyrale” e zgjedhësve, ata zgjedhës që janë regjistruar si votues nga jashtë vendit sipas njoftimit të KQZ-së. DPGJC-ja njofton me shkrim KQZ-në për aneksimin e zgjedhësve që janë regjistruar në listën e zgjedhësve që votojnë jashtë vendit nga lista natyrale e zgjedhësve.
- 1.5.3.** Auditët teknikienë ngarkohen të ndjekin dhe auditojnë procedurën e aneksimin të zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit nga lista natyrale e zgjedhësve. Auditët teknikienë raportojnë gjetjet e tyre jo më vonë se 1 ditë pas përfundimit të afatit të përcaktuar në pikën 1.5.1.
- 1.6.** Fushata e sensibilizimit dhe e informimit mbi procedurat e regjistrimit.
- 1.6.1.** KQZ do të hartojë një spot televiziv, për të informuar/ sensibilizuar/ ndërgjegjësuar zgjedhësit me banim jashtë vendit për procedurat e regjistrimit dhe mënyrën e plotësimit/ ndërveprimit me sistemin.
- 1.6.2.** KQZ do të bëjë një fushatë informuese të sponsorizuar përmes faqes zyrtare të KQZ, rrjeteve sociale si *Facebook*, *Twitter*, *Youtube*, etj. për të ndërgjegjësuar zgjedhësit të marrin pjesë në këtë proces. Kjo fushatë do të fokusohet tek zgjedhësit të cilët kanë vendbanim jashtë territorit të RSH.
- 1.6.3.** KQZ do të bashkëpunojë me ambasadat, misionet diplomatike, për të përcjellë mesazhet informuese për procedurën e regjistrimit, rëndësinë e pjesëmarrjes në votim, mënyrën e votimit dhe protokollet teknike për realizimin.
- 1.6.4.** Kjo fushatë do të bëhet nga momenti i miratimit të rregullave dhe do të zgjasë deri në përfundimin e afatit të regjistrimit.
- 1.7.** Modele nga vende te ndryshme.
- 1.7.1.** Austria: Lista e përhershme e zgjedhësve mbahet në ZGJC-në e çdo bashki në bazë të regjistrimit civil. Zgjedhësit që banojnë jashtë vendit caktohen në vendbanimin më të fundit që kanë pasur para largimit. Aplikimi qoftë *online* apo *manualisht*, nga austriaket të cilët banojnë jashtë vendit të tyre duhet të paraqesin kopje të





pasaportës/ID-së, leje drejtimi dhe ja dërgon njësisë administrative me postë, fax, email (të skanuar) ose personalisht. Në këtë formulari ai mund të kërkojë të përfshihet në listën e zgjedhësve (evropian, jashtë vendit). Regjistrimi i shtetasve austriakë të cilët kanë vendbanim të përhershëm jashtë vendit kërkohet të kenë aplikim aktiv (me status aktiv) për tu pranuar në listën e zgjedhësve (regjistri i votuesve). Aplikanti identifikohet me një kartë identiteti apo nënshkrim telefonik mobile, kodi aplikimi (ky kod i dërgohet votuesit me një informacion zgjedhor zyrtar); me një numër pasaporte ose me një foto të ID-së të skanuara. Gjithashtu votuesit austriakë mund të dorëzojnë aplikimin e tyre edhe fizikisht ose me email në njësitë administrative ku ata kanë jetuar.

**1.7.2.** Bosnja dhe Hercegovina: KQZ-ja është përgjegjëse për mirëmbajtjen e Listës së zgjedhësve për saktësinë dhe integritetin e saj. Regjistrimi *online* nuk lejohet. Zgjedhësit që banojnë jashtë BeH-së duhet të dorëzojnë një kopje të kartës ID me postë. Kartat e huaja pranohen vetëm për refugjatët por jo për zgjedhësit që banojnë përkohësisht jashtë vendit. Ligji nuk kërkon provë për adresën jashtë vendi për shkak të problematikave që i krijon KQZ-së përfshirë adresat e rreme, apo regjistrime të shumëfishta në të njëjtën adresë. Zgjedhësit JV janë të detyruar të dorëzojnë aplikimin e nënshkruar për tu përfshirë në listën e zgjedhësve JV për çdo zgjedhje dhe të konfirmojnë apo ndryshojnë regjistrimet e mëparshme nëpërmjet postës. Në aplikim duhet të zgjedhin nëse do të votojnë fizikisht në misionet diplomatike apo me postë. KQZ përgatit një listë zgjedhësish të veçantë dhe i përjashton ato nga lista kryesore e zgjedhësve që votojnë në QV-të e rregullta.

**1.7.3.** Sllovenia: Lista e zgjedhësve nga jashtë ndahen në dy kategori: a) Zgjedhës që kanë të regjistruar vendbanimin e përhershëm jashtë vendit; b) zgjedhës që kanë emigruar nga Sllovenia dhe hyjnë në një listë të posaçme të cilët nuk e kanë të regjistruar vendbanimin e përhershëm jashtë Sllovenisë. Zgjedhësit pa një vendbanim të përhershëm në Slloveni kanë të drejtë të votojnë në njësinë zgjedhore ku ata ose prindërit e tyre kanë pasur vendbanimin e përhershëm. Sllovenia ka një sistem pasiv të regjistrimit të zgjedhësve. Vendbanimi i përhershëm jashtë vendit mund të deklarohet nëpërmjet portalit e-uprava (administratë elektronike) duke përdorur nënshkrim elektronik që përkon nënshkrimin e personit, në përputhje me legjislacionin e transaksioneve dhe nënshkrimeve elektronike. Shtetasit që nuk kanë vendbanimin e përhershëm në Slloveni nëse duan të votojnë me postë duhet të njoftojnë KQZ-në nëpërmjet një formati të publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në Slloveni, e cila nënshkruhet e skanohet si dhe përcillet me postë, faks, e-mail. Zgjedhësit kanë edhe opsionin për tu regjistruar me shkresë. Lista e zgjedhësve nuk publikohet dhe nuk shpërndahet me qëllim ruajtjen e të dhënave personale.

